



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 57 Prot.

Tiranë, më 15.01 2019

VENDIM Nr. 11, datë 15.01.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1, datë 15.01.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Ndërtim i një stacioni të ri të rrjetit telefonik Telekom Albania, Kepi i Rodonit 1563 dhe hapja e rrugës së re me gjatësi 143 ml*", fshati *Shetaj, Durrës* -subjekti "*TELEKOM ALBANIA*", realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Ndërtim i një stacioni të ri të rrjetit telefonik Telekom Albania, Kepi i Rodonit 1563 dhe hapja e rrugës së re me gjatësi 143 ml*", fshati *Shetaj, Durrës* -subjekti "*TELEKOM ALBANIA*", realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.
2. Subjekti "*TELEKOM ALBANIA*" duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "*Ndërtim i një stacioni të ri të rrjetit telefonik Telekom Albania, Kepi i Rodonit 1563 dhe hapja e rrugës së re me gjatësi 143 ml*", fshati *Shetaj, Durrës*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e sipërpërmendur dhe do të mbikëqyrë subjekt të licencuar në arkeologji.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR

SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al